





Bujqësia e nis vitin në rënie! Ekspertët: Duhet bankë shtetërore për fondet dhe kreditë për sektorin

Faqe 6



Marrëveshja për Sigurinë Ushqimore me Kosovën, Denaj: Adreson sfidat e pazgjidhura

Faqe 2



“Urat e reja për Shqipërinë 2030”, Rama: Zhvillimi i pronës publike sipas modelit italian dhe spanjoll

Faqe 4



AGROBIZNESI

FED invest

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit janar 2025

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 501
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

NGA FERMA NË TREGJET E HUAJA

UDHËZUES PËR FERMERËT MBI PËRPUTHSHMËRINË ME STANDARDET E GLOBALGAP QË KONSIDEROHET SI TREGUESI MË I LARTË I BESUESHËM PËR TË DEMONSTRUAR SIGURI DHE QËNDRUESHMËRI USHQIMORE NË FERMË

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP) të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror të Çështjeve Ekonomike (SECO), përforcon cilësinë e produkteve dhe njohurive të fermerëve Shqiptarë përmes udhëzuesve

GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME | **ALBANIA**

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

UNIDO UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
State Secretariat for Economic Affairs SECO

GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME

NGA FERMA NË TREGJET E HUAJA

Udhëzues për fermerët mbi përputhshmërinë me standardet GLOBALGAP

GLOBALG.A.P.

Qeveria konsulencë nga UBT, Mazniku: Mundësi për ekspertizë në programet e BE-së

Faqe 4

HISTORI SUKSESI

30 vite sukses në Agroturizëm, Vreshtarinë & Kantinën "Vila-Shehi"

19 Dhjetor 2024, u shënuar 30-vjetori i Agroturizëm "Vila Shehi"

Faqe 6

BOTIM I RI

Akademia e Shkencave Tiranë, prezanton librin me titull "Bujqësia Biologjike" me autor Profesor Asistent dhe Doktor Enver Isufi

Nga: Agim Rrapaj, Presidenti i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH)

Faqe 10

TEMA TË DITËS

- Miratohet Paketa e Maleve, Gonxhja: Nxit kthimin e shumë shqiptarëve nga jashtë vendi Fq.7
- Një shije suksesi: Historia e Agromeljonit Fq.7
- Zgjidhje inovative për një Shkodër më të gjelbër: BE mbështet 5 ekipe sipërmarrësish Fq.2
- Bashkimet e fermerëve, përfitim 100% nga Skema Kombëtare Fq.4
- Bimësia spontane e mureve - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

FINANCIM

Grante deri në 2,5 mln lekë për 101 biznese, nxitje e eksporteve dhe inovacionit



Faqe 5

AKTUALITET

Denaj: 5,2 miliardë lekë mbështetje për bujqësinë, 67100 fermerë përfitues

Qeveria ka rritur rritur fondin e financimit për të mbështetur të gjithë fermerët përfitues të Skemës Kombëtare 2024.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, në një postim në rrjete sociale, bëri të ditur se me aktin normativ të fundvitit, mbështetja për bujqësinë dhe fermerët do të vijoje.

bursohen 100%", tha ministria.

Denaj informoi se, për të tretin vit radhazi, sigurojmë 100% pagesa për fermerët e kualifikuar të Skemës Kombëtare direkte, teksa vuri në dukje se mbështetja për bujqësinë dhe fermerët do të vijoje.

Në Skemën Kombëtare 2024

tjera, bimët mjekësore – aromatike, si edhe mbështetje me naftë për punimet e mekanizuar në bujqësi.

Qëllimi i këtyre masave është ulja e kostove për fermerët dhe rritja e rendimentit të prodhimit vendas.

Ministria Denaj, ndau në rrjete sociale historinë e Sado Metushit nga Boçova e Fierit, që në moshën 70-vjeçare vijon me pasion mbarështimin e të imtave.

Denaj tha se, ai mbarështon 400 krerë dele dhe 350 qengja, duke përfituar mbështetje 100% nga Skema Kombëtare për Blegtorinë dhe Naftën.

Matoshi tregon se është përfitues i mbështetjes me subvencione për disa vite me radhë.

“Unë kam aplikuar dhe kam marrë financim nga shteti për blegtorinë, por dhe subvencionim të naftës që përdor në bujqësi”, u shpreh ai.

Skema e Mbështetjes në Bujqësi është një politikë e qeveria që do vijoje të financojë drejtpërdrejtë fermerët në të gjithë vendin.



arrin në një total prej 5,2 miliardë lekë.

“Janë 67 100 fermerë përfitues, ku 52 195 prej tyre përfitojnë naftë dhe do të dis-

ofrohet mbështetje për: tufën bazë të matrikulluar (gjedhë dhe të imta), bletarinë, fermat organike, certifikimi Global Gap, fara, fidanë dhe inpute të

Zgjidhje inovative për një Shkodër më të gjelbër: BE mbështet 5 ekipe sipërmarrësish

Circular City Labs Shkodra do të mbështetë financiarisht 5 ekipe sipërmarrësish të rinj për të zhvilluar zgjidhje të qëndrueshme në menaxhimin e mbetjeve dhe promovimin e ekonomisë qarkulluese në Shkodër.

Pas dy muajsh trajnime

nga idetë kryesore përfshijnë: Transformimi i mbetjeve tekstile në produkte të reja dhe të ripërdorshme, duke reduktuar mbetjet industriale dhe krijuar mundësi pune.

Shndërrimi i mbetjeve ushqimore në produkte të reja, duke ndihmuar në luftën kundër

(EU4CELC) dhe BE për Innovation (EU4I), të bashkëfinancuara nga Bashkimi Evropian (BE), Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), në bashkëpunim me qeverinë shqiptare.

Ky program synon të fuqizojë individët dhe bizneset në Shkodër për të zhvilluar zgjidhje të qëndrueshme për menaxhimin e mbetjeve, duke kontribuar në ndërtimin e një ekonomie qarkulluese dhe të gjelbër, duke vendosur standarde të reja për qëndrueshmërinë dhe inovacionin në qytetin e Shkodrës.

Circular City Labs Shkodra (CCL Shkodra) është një program akselerimi inovativ i krijuar për të adresuar sfidat urbane të menaxhimit të mbetjeve, duke nxitur zgjidhje të bazuara në ekonominë qarkulluese. Pas suksesit të Circular City Labs – Tiranë, ky program tani zgjerohet në Shkodër, me fokus në zhvillimin e zgjidhjeve të qëndrueshme kryesisht për mbetjet organike, mbetjet e paketimit dhe mbetjet tekstile. Synimi kryesor është krijimi i qyteteve më të gjelbra dhe më të jetueshme, përmes zgjidhjeve që reduktojnë, ripërdorin dhe riciklojnë këto lloje mbetjesh.



shpërdorimit të ushqimit. Riciklimi i materialeve organike përmes platformave dixhitale që lidhin bizneset me fermerët dhe kompostuesit, duke promovuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve.

Përdorimi kreativ i mbetjeve plastike dhe ambalazhit për të reduktuar ndotjen dhe promovuar praktikën e riciklimit.

Në një njoftim për shtyp zyra e GIZ në Shqipëri bëri të ditur se, CCL Shkodra është një nismë e mbështetur nga projektet BE për Circular Economy and Livable Cities

Akti Normativ, Denaj: Financim rivitalizimit të 6 tregjeve rajonale

Akti Normativ i miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave këtë javë, parashikon edhe financimin e rivitalizimit të 6 tregjeve ushqimore në Shkodër, Pukë, Vlorë, Durrës, Divjakë, Gjirokastrë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj bëri të ditur se me këtë fond, Qeveria shqiptare dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mbështetë rivitalizimin e tregjeve tradicionale, të cilat do të shërbejnë për garantimin e tregtimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, rritjen e fuqisë negociuese të fermerëve në çmime, si dhe promovimin e produkteve bujqësore dhe turistike të zonës.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural organizoi

thirrje publike si dhe ftoi të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore për pjesëmarrje në

cionale.

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe në raport



konkurim dhe paraqitjen e dokumentacionit, për projektin e rivitalizimit të tregjeve tradi-

me kriteret e përcaktuara nga MBZHR u bë vlerësimi dhe u përzgjedhën 6 projekte.

Marrëveshja për Sigurinë Ushqimore me Kosovën, Denaj: Adreson sfidat e pazgjidhura

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj u shpreh, një ditë pas nëshkrimit të Marrëveshjes së

përbashkët me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, që forcon bashkëpunimin mes Shqipërisë dhe Kosovës.

mbështetur fermerët dhe fuqizuar tregtinë mes dy vendeve”, tha ajo.

Kjo marrëveshje e lidhur mes ministrave do të zbatohet nga institucionet përgjegjëse të varësisë për fushat e përgjegjësisë së lidhjes së kësaj marrëveshjeje.

Për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Republikën e Shqipërisë do të jetë zbatues Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) dhe Instituti i Sigurisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (ISUV).

Për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Republikën e Kosovës do të jetë zbatues Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, (AUV) dhe Laboratori Ushqimit dhe Veterinarisë (LUV).



Bashkëpunimit për Sigurinë Ushqimore, Veterinari dhe Fitosanitare me homologun e Kosovës, Faton Peci, se dje u ndërmor një tjetër angazhim i

“Kjo marrëveshje adreson sfidat e pazgjidhura dhe krijon një kornizë të re për një treg më të sigurt dhe të unifikuar për prodhimet tona, duke

Skema Kombëtare, Denaj: Prodhimi në serra 100% mbështetje për masën fara-fidanë

Gramoz Gjojdeshi në fshatin Petovë të Fierit ka 25 vite përvojë në kultivimin e domatëve në serra, në një sipërfaqe prej 1,5 hektarësh.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj ndau në rrjete sociale historinë e Gramozit, që prodhon domate të cilësisë së lartë jo vetëm për tregun vendas, por edhe për eksport, duke promovuar markën “Made in Albania” në tregjet ndërkombëtare.

“Gramozit është përfitues në masën 100% i Skemës Kombëtare të Subvencioneve për masën fara-fidanë”, tha Denaj.

Ministria bëri të ditur se, me aktin normativ të fundvitit, mbështetja për bujqësinë dhe

blegtorinë arrin në një total prej 5,2 miliardë lekë. 67 100 fermerë përfitues, ku 52 195 prej tyre përfitojnë naftë do të disbursohen 100%.

“Për të tretin vit radhazi, sigurojmë 100% pagesa për fermerët e kualifikuar të Skemës Kombëtare direkte”, u shpreh Denaj.



UNIDO

NGA FERMA NË TREGJET E HUAJA

UDHËZUES PËR FERMERËT MBI PËRPUTHSHMËRINË ME STANDARDET E GLOBALGAP QË KONSIDEROHET SI TREGUESI MË I LARTË I BESUESHËM PËR TË DEMONSTRUAR SIGURI DHE QËNDRUESHMËRI USHQIMORE NË FERMË

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP) të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror të Çështjeve Ekonomike (SECO), përforcon cilësinë e produkteve dhe njohurive të fermerëve Shqiptarë përmes udhëzuesve



UNIDO UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
State Secretariat for Economic Affairs SECO

GQSP
GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME

NGA FERMA NË TREGJET E HUAJA
Udhëzues për fermerët mbi përputhshmërinë me standardet GLOBALGAP

GLOBALG.A.P.



NGA FERMA NË TREGJET E HUAJA:
Udhëzues për fermerët mbi përputhshmërinë me standardet GLOBALGAP

Qëllimi i udhëzuesit GlobalG.A.P është të ndihmojë bizneset në procesin e tyre të certifikimit GlobalGAP, të sigurojnë përputhshmëri me praktikën ndërkombëtare bujqësore dhe të rrisin konkurrencën e tyre në treg.

GlobalGAP është një standard i njohur ndërkombëtar për praktikën e menaxhimit të fermave. Misioni i tij është të vendosë standarde dhe procedura të pranuar gjerësisht për certifikimin e produkteve bujqësore në nivel global.

GLOBALG.A.P.

AVANTAZHE E CERTIFIKIMI GLOBALGAP

Për fermerët

- » Tregje të reja
- » Rritje e konkurrueshmërisë
- » Cmime më të larta

Për konsumatorët

- » Sigurinë ushqimore: Masat për të parandaluar kontaminimin e ushqimeve
- » Zgjedhje të shumta dhe transparence
- » Përmirësimi i mirëqenies së komunitetit

Për ambientin

- » Inkurajon praktika të qëndrueshme bujqësore, duke përfshirë përdorimin e efektiv të ujit dhe plehrave, dhe zvogëlon ndikimin negativ në ambient
- » Promovon praktika që ruajnë shëndetin e tokës dhe biodiversitetin, duke mbrojtur mjedisin dhe habitatin natyror
- » Praktika që reduktojnë ndikimin mjedisor të bujqësisë, siç janë menaxhimi i qëndrueshëm i ujit dhe përdorimi i kontrolluar i pesticideve dhe plehrave kimike



HAPAT DREJT CERTIFIKIMIT



1. Përgatitja dhe aplikimi: Plotësoni dhe dorëzoni formularin e aplikimit tek organi i certifikimit (kohezgjatja 1-2 muaj).
2. Rishikimi i dokumentacionit nga trupa e certifikimit (p.sh., regjistrat e fermës, praktikën e menaxhimit) (1 muaj).
3. Inspektimi përfshin intervistime, inspektim të objekteve dhe rishikim të praktikave (1-2 muaj).
4. Raporti i auditit dhe veprimet korektuese nga organizata e certifikimit (1-2 muaj).
5. Implementoni veprimet korektuese nëse identifikohen mangësi (1 muaj).
6. Vendimi për Certifikim (1 muaj).
7. Pas miratimit, organi i certifikimit jep certifikatën GlobalG.A.P.

KËRKESAT PËR CERTIFIKIM

- » Udhëzime për organizimin e fermës, infrastrukturën, dhe higjienën (p.sh. udhëzimet për organizimin e rrugëve brenda fermës për të lehtësuar aksesin dhe kontrollin e trafikut të mjeteve bujqësore).
- » Menaxhimi i tokës (p.sh. praktika për testimin e rregullt të pH-së së tokës dhe përdorimi i rregullt i plehrave organike për të mbajtur fertilitetin e tokës).
- » Mbrojtja e kulturave bujqësore: IPM, përdorimi i pesticideve dhe mbajtja e regjistrimeve (p.sh. përdorimi i feromoneve).
- » Përdorimi efikas i ujit, standardet e cilësisë dhe praktikën e zjarëdhënies.
- » Përdorimi i plehrave: aplikimi i duhur, ruajtja, dhe mbajtja e regjistrimeve për plehrat (ruajtja e plehrave në depo të mbyllura dhe mbajtja e regjistrimeve të sasisë dhe llojit të plehrave të përdorura).
- » Kullimi dhe trajtimi pas kullimit: procedurat për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e produktit nga kullimi deri te ruajtja.
- » Shëndeti, siguria dhe mirëqenia e punëtorëve: udhëzime për sigurinë e punëtorëve, trajnimet, dhe kushtet e punës (p.sh. organizimi i trajnimeve vjetore për procedurat e sigurisë në përdorimin e mjeteve bujqësore).

Dokumentimi dhe mbajtja e të dhënave

Dokumentacioni i nevojshëm përfshin hartën e fermës, regjistrat e kulturave, regjistrat e përdorimit të pesticideve dhe regjistrat e trajnimeve të punonjësve.

Praktikat e mbajtjes së regjistrimeve: përdorimi i sistemeve të automatizuara për regjistrimin e të dhënave, dhe rregullimi i dosjeve të regjistrimit në mënyrë që të përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar.

Roli i trupës së certifikimit

- » Konsultim fillestar për të shpjeguar procesin dhe kërkesat e certifikimit
- » Shërbime vlerësimi paraprak dhe planifikimi për auditim
- » Komentet dhe rekomandime për veprime korigjuese
- » Lëshon certifikatën GlobalGAP nëse ferma rezulton të jetë në përputhje
- » Auditime të rregullta mbikëqyrëse për të siguruar përputhshmërinë e vazhdueshme me standardet GlobalGAP
- » Monitoron veprimet korigjuese dhe përmirësimet e bëra bazuar në gjetjet e auditimeve të mëparshme
- » Menaxhon procesin e rinovimit për të ruajtur vlefshmërinë e certifikimit.
- » Ofron mbështetje dhe udhëzime të vazhdueshme për të ndihmuar fermën të ruajë përputhshmërinë
- » Ofron përditësime mbi ndryshimet në standardet dhe kërkesat e GlobalGAP



GQSP
GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME

NJË INICIATIVË GLOBALE

GQSP ndihmon prodhuesit e vegjël për të përmirësuar cilësinë e produkteve të tyre, të përmirësojnë standardet ndërkombëtare dhe të eksportojnë nëpër botë

UNIDO UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Gripi i shpendëve, Ministria e Bujqësisë: Situata nën kontroll, mbikëqyrje zonave deri në 10 km nga vatra e shpërthimit

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural informon publikun mbi situatën e sëmundjes së Influcencës Aviare se janë marrë të gjitha masat për kontrollin dhe monitorimin e fermave të ndodhura në zonat e mbrojtjes (3 kilometra) dhe atë të mbikëqyrjes (10 kilometra) nga vatra e shpërthimit të sëmundjes, prej datës së konfirmimit të infeksionit 28.12.2024 në fshatin Cekrez-Morinë, njësi administrative Zall-Herr.

Sipas MBZHR-së, sektori

mjediseve dhe mjeteve të kontaktit me shpendët.

Ndërkohë sektori veterinar i Qarkut Vlorë menjëherë pas konfirmimit të rezultatit pozitiv nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për sëmundjen e Influcencës Aviare, të nëntipit H5N1 në shpendë të egër të ngordhur në zonën bregdetit të Plazhit të Vjetër të Vlorës, në datën 05.01.2025, ka marrë të gjitha masat për kontrollin dhe monitorimin e situ-

cilët mendohen se janë sjellë nga vala dhe mund të kenë ngordhur disa ditë më parë. Tri karkasa tepër të dëmtuara u propozën menjëherë sipas procedurave të përcaktuara, ndërsa dy karkasa u dërguan në datën 06.01.2025 për analiza në Laboratorin e Referencës – ISUV, të cilat rezultuan pozitive me Influcencë Aviare, nëntipi H5N1.

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, përveç intensifikimit të kontroleve ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me autoritetet vendore të Zonave të Mbrojtura, Pushtetit Vendor, Policisë së Shtetit dhe Njësive të Kujdesit Shëndetësor, për informacion dhe monitorim të ndërsjellë.

Instituti i Shëndetit Publik ka kryer kontrollin dhe marrjen e kampioneve nga njerëz në vatrën dhe zonat e kontaktit, të cilat deri tani kanë rezultuar negative.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka mbledhur në mënyrë ditore Qendrën Kombëtare të Krizës me përfaqësues nga Instituti i Shëndetit Publik, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për një koordinim të procesit në rrugë ndërinstitucionale.

Ndërkohë janë në fuqi urdhrat e menjëhershëm të Ministrit, për ndalimin e shitjes dhe tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e: Njësive Administrative Vlorë; Njësive Administrative Qendër; Shushicë; Orikum; Kotë; Paskuqan; Dajt; Tiranë; Farkë; Bërxull; Vaqarr; Kasha; Kamëz; Zall-Herr; Zall-Bastar.

atës. Çdo ditë 7 grupe pune janë në terren për monitorimin e situatës dhe gjurmimin e hershëm të infeksionit, kanë vijuar kontrole përgjatë vijës bregdetare, duke përfshirë zonën nga Tuneli i Ujit të Ftohtë deri në Zvërnec, përveç Lagunës së Nartës; Lagunës së Novoselës; Plazhit të Vjetër; Orikumit; Lagunës së Butrintit; Lagunës së Karavatasë dhe Semanit.

Si rezultat i intensifikimit të monitorimit, po në datë 05.01.2025 ora 20:00, Drejtorja Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë ka njoftuar për 5 shpendë të tjerë egër dhe të ngordhur, të gjendur në bregdetin e Plazhit të vjetër, të



veterinar i Qarkut Tiranë ka kontrolluar me anë të 11 grupeve të kontrollit ditor, njësitë administrative dhe fshatrat e vendosura nën mbikëqyrjen veterinarë, duke bërë të mundur identifikimin e menjëhershëm të një rasti të ri në Paskuqan, në datën 06.01.2025. Ferma e oborrit familjar me 10 krerë shpendë është kontrolluar pa vonesë dhe janë marrë masat për analizimin laboratorik me metodën konfirmatore RT-PCR, e cila ka konfirmuar praninë e virusit të Influcencës Aviare të nëntipit H5N1. Është kryer eliminimi dhe asgjësimi i sigurt i shpendëve të fermës sipas procedurave sanitario-veterinare, si dhe është kryer dezinfektimi rigoroz i

Qeveria konsulencë nga UBT, Mazniku: Mundësi për ekspertizë në programet e BE-së

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Arbjan Mazniku dhe Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Fatbardh Sallaku, firmosën një marrëveshje bashkëpunimi me të cilën, Universiteti do të ndihmojë qeverinë në fushat e konsulencës dhe ekspertizës për kërkime shkencore për nevojat e qeverisë në fusha të ndryshme.

Ministri Mazniku tha se ky bashkëpunim është i rëndësishëm në kuadër të aksesimit të fondeve të Bashkimit Europian ku do të duhen stafe të trajnuara dhe të afta për të thithur fonde.

“Unë mendoj që kjo është një farë, një element i parë, një embrion i një bashkëpunimi që mund të bëhet tejmasë i madh nëse secili prej nesh e sheh të plotë potencialin se ku ky bashkëpunim mund të shkojë. Ne duhet të bashkërendojmë punën, të bëjmë ushtrime bashkërendimi sot në mënyrë të kemi mundësi të aksesojmë nga programet e BE një sasi që është shumë herë më e madhe se totali i financimeve që

ka sot Shqipëria për gjithë bashkitë”, tha ministri Mazniku.

Rektori i UBT-së, Fatbardh Sallaku tha se tashmë është mundësia e të gjithë profesorëve të tregojnë veten për projekte që

kompanie konsulencë private në Shqipëri, që ne si staf jemi ankuar dhe ankohemi nëpër kafenetë tona, që pse ia dha atij apo asaj. E vlerësojmë shumë dhe jam shumë i sigurt që në harkun ko-



më parë kryheshin vetëm nga kompani konsulencë të huaja. “Ne duhet të demonstrojmë çfarë jemi dhe çfarë jemi të gatshëm të bëjmë. Topi është në fushën tonë. Unë e di shumë mirë që kjo marrëveshje mund t'i ofrohej kujtdo

hor të 4-5 muajve ne do të kemi produktet e para”, tha në fjalën e tij rektori Sallaku.

Marrëveshja e firmosur ka një kohëzgjatje njëvjeçare me mundësinë për t'u rinovuar në varësi të rezultateve.

“Urat e reja për Shqipërinë 2030”, Rama: Zhvillimi i pronës publike sipas modelit italian dhe spanjoll


Kryeministri Edi Rama është i pranishëm në prezantimin e programit “Urat e reja për Shqipërinë 2030”. Një program i ri zhvillimi i pronave publike, për të ndërtuar përmes partneriteteve me sipërmarrjen private vepra të reja të infrastrukturës publike, administrative, turistike, kulturore e sociale

Në aktivitet, që po zhvillohet në Tiranë marrin pjesë ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhja dhe drejtoresha ekzekutive e “Albanian Investment Corporation”, Elira Kokona. I pranishëm është edhe kreu i bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj.

Rama tha se, “ky është prezantimi i një faze të re e programit të zhvillimit të pronave publike në funksion të përmirësimit të kushteve të administratës shtetërore, lidhur me hapësirat e punës dhe po ashtu në funksion të krijimit të partneriteteve të cilat do të japin mundësi që nga zhvillimi i pronave publike të përfitojë drejtpërdrejtë financiarisht edhe sektori publik”.

“Besoj që të gjithë i keni

parasysh ende sot e gjithë ditën skelete fabrikash, apo ndërmarrjesh të vjetra që vijojnë të cenojnë peizazhin tonë dhe janë shëmbëlltira të proceseve të shkuara të privatizimeve, të cilat në një pjesë të konsiderueshme nuk kanë sjellë asnjë rezultat tjetër përveç de-



gradimit të mëtejshëm të këtyre aseteve”, tha Rama.

Ndërkohë që, shtoi Rama, “ne jemi sot këtu për të ndarë me ju një qasje tërësisht tjetër të bazuar në eksperiencat dhe praktikatat më të mira ndërkom-

bëtare, nisur posaçërisht nga eksperiencat e Italisë dhe të Spanjës, të cilat prej shumë e shumë vitesh kanë ngritur struktura të ngjashme me strukturën e Korporatës Shqiptare të Investimeve, ose siç e quajmë edhe ligjërisht Albanian Investment Corporation,

struktura që janë pikërisht në dispozicion të sektorit publik dhe shërbejnë si ura shumë të fuqishme për ndërveprime dhe bashkëpunime komplekse me sektorin privat”.

Bashkimet e fermerëve, përfitim 100% nga Skema Kombëtare

Në fshatin Mbrostar të Fierit, Alfredi bashkë me 4

kultivojnë me prodhime bujqësore të stinës.

Kombëtare 2024 për fidanë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, ndau në rrjete sociale rastin e fermerëve të bashkuar, që e ka bërë më të lehtë aplikimin dhe përfitimin e tyre nga Skema Kombëtare e mbështetjes në bujqësi.

Denaj tha se, “me aktin normativ të fundvitit, mbështetja për bujqësinë dhe blegtorinë arrin në një total prej 5,2 miliardë lekë 67100 fermerë përfitues, ku 52195 prej tyre përfitojnë naftë do të disbursohen 100%”.

Sipas saj, për të tretin vit radhazi, sigurojmë 100% pagesa për fermerët e kualifikuar të Skemës Kombëtare direkte.



fermerë të tjerë, janë bashkuar në një grup dhe zotërojnë 2,3 hektarë tokë që e

Ata kanë aplikuar si grup fermerësh dhe kanë përfituar 100% mbështetje nga Skema

Preçi: Qarku Shkodër i pastër pas kontrolleve për murtajën e derrave

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka në fokus forcimin e kontrollit dhe garantimin e sigurisë ushqimore në tregjet e vendit për sektorin blegtoral.

Shërbimi veterinar ka vijuar kontrollin në të gjithë zinxhirin blegtoral edhe këtë fillimvit. Sipas specialistëve, monitorimi ka në fokus edhe murtajën e derrave.

Deri tani qarku i Shkodrës

mbetet i pastër, ndonëse vend kufitar me Lezhën, ku javë më parë ngordhën disa bagëti të prekura nga kjo sëmundje.

Shefi i Shërbimit Veterinar, Mark Preçi, tha për mediet se, “në qarkun Shkodër, sot për sot nuk kemi asnjë rast të kafshëve të dyshimta apo pozitive për sa i përket murtajës afrikane të derrave”.

Sipas tij, për shkak të situatës, vëmendja do të jetë e

shtuar në çdo bashki të qarkut.

“Ne kemi rritur sistemin e alertit dhe jemi në kontakt të vazhdueshëm me fermerët. Veterinerët e shërbimit janë në terren pa ndalim, dhe nuk raportohet asnjë rast i dyshuar”, theksoi Preçi.

Në Shkodër operojnë dy stabilimente të rritjes dhe përpunimit të mishit të derit dhe aty kontrollat do të jenë periodike.

FINANCIM

Bujqësia e nis vitin në rënie! Ekspertët: Duhet bankë shtetërore për fondet dhe kreditë për sektorin

Spektori i bujqësisë e nis vitin në rënie dhe me financim të pamjaftueshëm. Ekspertët thonë se problemet e sektorit nuk do të zgjidhen as me garancinë sovraane të premtuar 2 miliardë lekë, pasi duhet një paketë fiskale dhe grante për ta ringritur bujqësinë. Fondet dhe kreditë sipas kreut të Agrobiznesit Shqiptar Agim Rrapaj, duhet të menaxhohen nga një bankë shtetërore

Siguria kombëtare varet edhe nga bujqësia, një tezë kjo e provuar edhe në kohë lufte. Sa më i madh prodhimi vendas aq më pak rriten çmimet, por kur prodhimi ngec, ekspozimi nga tregjet e huaja është i lartë dhe inflacioni rritet.

“Në momentin që ndodhi lufta në Ukrainë ne ju kthjem bujqësisë, grurit, mbështetjes financiare, por kjo nuk bëhet me sustë. Bujqësia do të vazhdojë të mbetet element i rëndësishëm i sigurisë kombëtare, dhe nuk duhet ta lëmë bujqësinë në minus siç po ndodh”, shprehet kreu i Agrobiznesit Shqiptar Agim Rrapaj.

2025-a e gjen bujqësinë në situatë jo të mirë, me mungesë të fondeve të IPARD, me kreditim anemik nga bankat, vetëm 2.5 miliardë lekë hua u dhanë deri në nëntor të 2024, por edhe me financim të ulët nga buxheti i shtetit.

“Përsa i përket financimit nuk po mbështetet jo sa duhet, por as sa minimumi i nevojshëm që



kërkon bujqësia. Është llogaritur që të ketë mbështetje minimale sektori privat dhe të gjithë sektorët e ekonomisë së shpenzimit, kërkohen edhe 90 milionë euro të tjera. Ngriu IPARD, ne duhet t'i kishim rritur ndjeshëm shpenzimet buxhetore për mbështetjen e sektorit”, thotë Rrapaj.

Kreu i Agrobiznesit Agim Rrapaj është skeptik edhe për garancinë sovraane që pritet të miratohet këtë vit në vlerën 2 miliardë lekë, pasi bankat kanë kushte dhe kritere të forta që duhen plotësuar, që fermerët nuk shumicën e rasteve nuk i plotësojnë.

“Bankat tona nuk janë të specializuara në profil bujqësor, por një nga degët e tyre duhet të kishte profil bujqësor-ushqimor, në mënyrë që të disbursohen këto garanci sovraane në favor të bujqësisë”, pohon ai.

Në një situatë të tillë Rrapaj thotë se zgjidhje do të ishte një bankë zhvillimi shtetërore.

“Duke pasur parasysh që bankat nuk po japin mbështetjen që ne presim për sektorin e bujqësisë, qeveria duhet të mendojë për një bankë zhvillimi në mënyrë që të gjitha fondet që vijnë për këtë sektor të përqendrohen në

një bankë zhvillimi që të ekuilibrohet bujqësia”, tha Rrapaj.

Pikë e dobët e sektorit mbetet edhe skema e TVSH-së, kur fermerët i blejnë lëndët e para për aktivitetin e tyre me TVSH, kurse produktet që prodhojnë i shesin pa këtë tatim.

“TVSH-ja është një gjak i keq i pakutur dhe kursit fiskal, kjo paketë është e padobishme për sektorin e bujqësisë. Një kompani vendase që merret me import dhe eksport, kur vjen puna për të blerë pëse ta marrë tek fermeri vendas të cilit nuk i rimburohet TVSH-ja, ai shkon e blen në import që i rimburohet TVSH-ja në doganë. Favorizohet importi”, tha eksperti.

Kontributi i bujqësisë në ekonomi në vitin e kaluar ishte negativ, ndërsa totali i buxhetit që pritet të shpenzohet këtë vit për zhvillimin rural dhe për skemat kombëtare për mbështetjen e fermerëve është 7.2 miliardë lekë nga 7 miliardë vjet.

HISTORI SUKSESI

30 vite sukses në Agroturizëm, Vreshtarinë & Kantinën “Vila-Shehi” 19 Dhjetor 2024, u shënua 30-vjetori i Agroturizëm “Vila Shehi”

Një ditë e shënuar për të gjithë aktorët e sektorit të vreshtarisë dhe verës në rajonin e Tiranës, por edhe gjithë Shqipërisë dhe më gjerë, pasi Agroturizëm “Vila-Shehi”, me ngritjen e bujtinës pranë kantinës, vizitohet nga qindra vizitorë, pikërisht nga qershori deri në tetor të vitit të shkuar është vizitur nga 1200 vizitorë të huaj, çka flet qartë për përkushtimin dhe pasionin e Z. Gazmend Shehi dhe familjes së tij në shërbim të çdo konsumatori që viziton kantinën dhe bujtinën.

Në këtë event të organizuar në ambientet e agroturizmit “Vila-Shehi”, morën pjesë disa personalitete nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e përfaqësuar nga Zv. Ministri Arjan Jaupllari, nga Bashkia Vorë, Kryetari Z. Blerim Shera, nga Këshilli i Agrobiznesit, Kryetari, Z. Agim Rrapaj, nga Shoqata e Operatorëve Turistikë dhe Hotelierisë përfaqësuar nga kryetari Z. Zak Topuzi, nga Universiteti Bujqësor, kryetarja e Shoqatës së Agroturizmit Shqiptar Znj. Johana Bano etj.

Eventin e nderuan edhe përfaqësues të komunitetit, konsumatorë, artistë, miq dhe të ftuar të veçantë, si: Z. Nexhmi Aliaj, përfaqësuesi i kompanisë “Eno-Alba”, prodhues të tjerë të verës në rajonin e Durrësit Z. Agron Xhafa (kantina “Amar”), Përmetit Z. Roland Dama (kantina “Dama”).

Në fjalën e mirseardhjes, Enologu Gazmend Shehi tha: “Ndiheh i nderuar sot, me praninë e miqve të kantinës, por edhe nga përfaqësues të institucioneve që kanë mbështetur sektorin e Agroturizmit. Në vitin 1994, unë isha student në shkollën teknologjike në Tiranë. Në atë kohë delikate sa i përket sektorit bujqësor, gjyshi im zotëronte 8 ha me prona, ku një pjesë e saj iu kthye si pjesë vreshti rreth 2 ha pas ndarjes së vitit 1992. Më pas, një ndihmë e veçantë ka qenë edhe babai, që e kemi të pranishëm këtu, Dr. Isuf Shehi, pasi ai është me profesion agronom dhe diti ta

menaxhojë dhe rigjenerojë më mirë prodhimin e rrushit për verë. Jam shumë i gëzuar, pasi atëherë mjaftoheshim vetëm për të përpunuar rrushin për verë, me qëllim konservimin e saj për nevojat e ekonomisë familjare, por ne vit pas viti filluam të investojmë në vreshtari dhe teknologji, ku aktualisht kapaciteti i prodhimit është 30-35 ton rrush/sezon. Pas përfundimit të shkollës së mesme ku fitova një profesion, vazhdova studimet e larta në UBT, ku diplomohem Inxhinier Teknolog. Më pas filloj punë në MBU, drejtorinë e bujqësisë dhe ushqimit (AKU). Por, asnjëherë nuk u shkëputa nga pasioni i prodhimit dhe shijimit të verës. Në vitin 2005, shpalle

degustatori më i mirë në Shqipëri në një trajnim që u zhvillua me mbështetjen e GTZ.

Në vitin 2008, botoj për herë të parë një libër praktik mbi veçoritë e prodhimit të verës bio.

Në vitin 2010, themelojmë shoqatën kombëtare “Prodhuesit e Verës Familjare”, ku anëtarësohemi në KASH.

Nga viti 2010 e në vazhdim, gjithmonë kam ngritur zërin në krahu e prodhuesve të verës, për t'i ndihmuar ata, promovuar, me sloganin “Nga vreshti në gotë, drejt një prodhimi dhe agroturizmi të qëndrueshëm”.

Me këtë objektiv kemi punuar edhe këto 30 vite në biznesin tonë familjar, tashmë të kërkuar nga shumë vizitorë.”

Fjalën e merr zv. Ministri Arjan Jaupllari, i cili theksoi se modele të tilla janë për t'u përgëzuar dhe shërbejnë për prodhues të tjerë, edhe me mbështetjen e MBZHR.

Sipas axhendës, fjala për Kryetarin e bashkisë Z. Blerim Shera: “Unë e falenderoj Gazin për ftesën dhe ndihmën e nderuar që shikoj dhe prek investime kaq të bukura në bashkinë tonë të Vorës dhe i uroj vetëm suksese të mëtejshme.

Më pas kryetari i KASH-it Z. Agim Rrapaj, theksoi se modele të tilla i bëjnë mirë rajonit të Tiranës dhe Shqipërisë. “Bashkë me anëtarin e KASH, Z. Gazi, ne kemi promovuar që nga fillimi orientimin e kantineve në Agroturizëm, ku tashmë numërohen

dhjetëra të tilla. Më vjen mirë që Agroturizëm “Vila-Shehi”, vizitohet nga shumë turistë, pasi është një pasaportë e mirë në promovimin e Shqipërisë.”

Fjalët përshëndetëse vazhduan përgjatë festës dhe drekës me produkte bio të shërbyera nga stafi i agroturizmit, ku nuk munguan surprizat e dhuratat për klientët e vjetër, miq të kantinës, të ftuarit dhe pjesëmarrësit.

Një informacion të plotë për kantinën ndiqeni më poshtë.

KANTINA & AGROTURIZEM “VILA-SHEHI” GJOKAJ, VORË, TIRANË. Shtrihet në kodrat e kurorës së Tiranës, ku kultivon rreth 5 ha me vreshta. Me një eksperiencë 30-

vjeçare në fushën e vreshtarisë dhe prodhimit të verërave.

Produktet e kantinës janë:
1. Shesh i bardhë
2. Shesh i zi
3. Rose
4. Gloria Sparkling (Shampanjë)
5. Reserve 2017
6. Raki Moskat
7. Merlot, verë pa alkool (0,0 Alkool)

Kantina është vlerësuar me disa çmime mbi cilësinë e verërve si:

Medalje ari, Sheshi i zi, aktivitet me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë, Maj 2012.

Bleta e Artë 2017, biznes i vogël i suksesshëm.

Medalje ari, Vera Shesh i bardhe 2017, aktivitet promovues “Rruga e verës”

Dy Medalje Argjendi në festivalin e verërave Berat, Reserve 2012 dhe Shesh i bardhë 2022.

Medalje Ari, Shampanja Gloria 2020, Aktivitet i Merano festival Tiranë 11-12 maj 2024

Slogani: DASHURONI JETËN TUAJ, SHIJONI VERËRAT TONA

Në Agroturizmin tonë do të gjeni:

- Shëtijë në vreshta
- Shijim verë & ushqim Bio
- Eksplorim i muzeut, bibliotekës, pikturave murale mbi historinë e verës
- Shërbim dhoma fjetje & Wine Spa (Banjo me verë)

Për të vizituar kantinën mjafton të klikoni në faqen e webit: www.vilashehi.com, mund të na ndiqni në: [GOOGLE MAP](https://www.google.com/maps); Vila-Shehi winery & Vineyards - Agritourisem

/Slowwine/Slow food, [instagram, vilashehi_winery](https://www.instagram.com/vilashehi_winery); facebook, VILA-SHEHI [tiktok: vilashehi etj.](https://www.tiktok.com/@vilashehi)

Telefon: 068 64 87370, 069 22 09157

Por mos harroni, ju duhet të rezervoni tavolinën tuaj më parë, për të shijuar shijen e kodrave të Tiranës.



AGROTURIZËM

Miratohet Paketa e Maleve, Gonxhja: Nxit kthimin e shumë shqiptarëve nga jashtë vendit

Këshilli i Ministrave miratoi bashkëpropozimin e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si dhe Ministrisë së Shtetit për Pushtetit Vendor, duke ia përcjellë Kuvendit, për Projektligjin e “Paketës së Maleve”.

Kjo nismë është një ftesë për gjithë diasporën, por edhe për qytetarët shqiptarë, për të investuar në tokat e gjyshërve të tyre duke i kthyer malet e Shqipërisë në destinacionin kryesor të turizmit malor në Ballkan.

Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhja, duke prezantuar nismën pas mbledhjes së qeverisë tha se miratimi i kësaj pakete nxit kthimin e shumë shqiptarëve nga jashtë vendit.

“Miratuar sot në qeveri projektligjin që ne e quajmë “Paketa e Malit”, që mua do të më pëlqente ta quaja një nismë për ekonominë e maleve, që është

një nismë që sjell një qasje alternative për të ndihmuar që ekonomia malore që ka ngelur pas ekonomisë të zonave urbane dhe zonave bregdetare të mund ta nxisim e ta shohim me përparësi duke shkuar më thellë në zonat rurale që kanë një potencial zhvillimi.

Gjithashtu do të lehtësonim dhe të nxisim që të kishim edhe diasporën dhe kthimin e shumë shqiptarëve, për t'u kthyer në tokat e të parëve edhe nga jashtë vendit ku ata mund të jenë sot, për të zhvilluar projekte që më pas ne do të bënim të mundur që t'i ndihmonim që të kishin një ecure më të shpejtë miratimi dhe zbatimi të këtyre

investimeve në zona që ne do për një zhvillim ekonomik të



t'i shpallim zona me përparësi mbështetur nga këto instrumente dhe me një nevojë prioritare që ne propozojmë me këtë pro-

jektligj”, tha Gonxhja.

Ndërsa ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Arbjan Mazniku tha se, “ky projektligj sjell një qasje për të rritur mundësitë dhe lehtësuar procedurat fiskale për të ndihmuar që ekonominë malore, që në vitet e fundit ka mbetur pas, ekonomisë së zonave urbane dhe bregdetare, të mund ta nxisim dhe fuqizojmë duke shkuar më thellë zonave rurale”.

“Malet mbeten burime të mëdha të mjedisit, burim i nënpërdorur. Paketa krijon një sinergji mes qeverisë qendrore dhe pushtetit vendor për zhvillimin turistik të gjithë maleve. Kjo paketë krijon mekanizma

që bashkitë të propozojnë zona për zhvillim malor dhe përfillojnë me ligj përparësi duke filluar nga lehtësira fiskale, zgjidhin probleme me pronësinë dhe thjeshtojnë lejet për këto zhvillim”, tha Mazniku.

Ai i bëri apel diasporës dhe investitorëve të shohin me përparësi sipërmarrjen në këto zona. “Qytetarët, investitorët, diaspora të orientojnë qëndrimin drejt maleve. Do t'i japë zhvillim maleve”, tha Mazniku.

Qëllimi i Projektligjit të miratuar sot nga qeveria është gjithashtu nxitja dhe tërheqja e investimeve për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë në ato zona malore, të cilat për shkak të burimeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore që ofrojnë, konsiderohen si zona të një rëndësie të veçantë me

(Vijon në faqen 11)

Armelen e takova në një dyqan të vogël e simpantik, që m'u duk si një thesar i fshehur



mes rugicave me kalldrëm të qytetit të vjetër të Beratit. Sapo hyra brenda, ndjeva menjëherë aromën ndjellëse të reçelrave të sapopërgatitur.

Teksa Armela na priti me një buzëqeshje të ngrohtë, sytë më shkuan menjëherë te gama e gjerë e produkteve artizanale të ekspozuara me shumë shije mbi tavolinë. Armela na ofroi me dashamirësi të provonim disa nga produktet e saj: reçel arrash, pjeshke dhe qershie e shumë produkte të tjera. Pas secilës kafshatë, më dukej sikur nisesha në një rrugëtim kulinar plot shije, i cili mbartte brenda vetes mjeshtërinë, dashurinë dhe sfidën për gjetjen e përsosmërisë.



Megjithatë, ajo që më mahniti nuk ishte thjesht shija e shkëlqyer e produkteve artizanale që provova. Çka më mahniti mbi të gjitha, ishte historia e Armelës, me pasionin dhe vendosmërinë e saj për të

arritur suksesin.

Armela — një vajzë e re, e zgjuar dhe ambicioze — nisi të më tregonte me dashamirësi për historinë e biznesit të saj të vogël, por tashmë tepër të suksesshëm.

E ndërkohë që ju tregoj për rrugëtimin e Armelës, ju ftoj të më ndiqni në një udhëtim në zemrën dhe shpirtin e Agromeljonit — një rrugëtim i mbushur me sfida dhe triumfe e i lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me shpirtin e një vaje të vendosur për të gdhendur rrugën e saj.

Agromeljoni u krijua nga Armela Qendro, një vajzë 28-vjeçare, teknologe ushqimore në profesion, e cila u kthye në Berat pas përfundimit të studi-

meve në Itali. E shtyrë nga një dëshirë e hershme për të pasur sipërmarrjen e saj, Armela, me mbështetjen e partnerit të saj Arjonit, themeloi Agromeljonin, një biznes i specializuar në prodhimin artizanal të një

sërë reçelrash organikë, salcës së domates, kompostove, glikove, uthullës së mollës së egër dhe një sërë produktesh të tjera me bazë frutat e thata.



Agromeljoni e zgjedh dhe grumbullon me shumë kujdes lëndën e parë nga fermerët e zonës së Karkanjozit, një fshat piktoresk në rrëzë të malit madhështor të Tomorrit.

Pavarësisht sfidave të shumta të lidhura me shitjet e paqëndrueshme dhe ekspertizën e kufizuar në marketing, Armela ishte e vendosur për ta shndërruar Agromeljonin në një sipërmarrje të suksesshme. Kur mësoi për programin e UNDP-së “Rritu me Biznesin Tënd”, ajo u tregua menjëherë e gatshme për t'u bërë pjesë e tij, duke e parë si një mundësi për rritje dhe zhvillim.

“Rritu me biznesin tënd” (Growing with Your Business — GYB) është një metodologji për mbështetjen e biznesit, që është zbatuar me sukses nga UNDP-ja në mbi 12 shtete të ndryshme, përgjatë 15 viteve të fundit.

Programi fokusohet kryesisht në sipërmarrjet mikro e të vogla, dhe synon të përmirësojë aftësitë e tyre të të bërit biznes, duke forcuar kapacitetet për të zgjeruar tregun dhe për t'u integruar në mënyrë më efektive në zinxhirët lokalë, kombëtarë e ndërkombëtarë të vlerës.

Me mbështetjen e Bashkisë Berat, GYB-i u pilotua për herë të parë në Shqipëri në 8 biznese

në këtë bashki.

Gjatë periudhës 6-mujore të ndërhyrjes, Armela punoi ngushtësisht me një konsulentë biznesi të dedikuar, e cila e

ndihmoi me konsulencë të personalizuar, në linjë me nevojat specifike të biznesit të saj.

“Investimi në pajisje nëpërmjet grantit të UNDP-së ishte gjithashtu një element shumë i rëndësishëm për përmirësimin e produktivitetit dhe rritjen e standardeve të sigurisë ushqimore në Agromeljon” — theksoi Armela.

Blerja e makinerive, duke përfshirë një arrëthyes, një pajisje për prodhimin e salcës, makineritë e bluarjes dhe tharjes së frutave dhe kontejnerët prej çeliku inox, i ndihmuan të transformonin procesin e tyre të prodhimit, duke rritur eficiencën dhe kontrollin e cilësisë.



Nga ana tjetër, zgjerimi në vendin e punës, i ndihmuan

i bazës së klientelës B2B dhe pjesëmarrja në panairat lokale dhe kombëtare, përmes mbështetjes së UNDP-së, rriti më tej vizibilitetin e Agromeljonit dhe i ndihmoi në zgjerimin e tregut të tyre.

“Për mua Agromeljoni nuk është thjesht një biznes për të bërë para duke shitur produkte. Për mua Agromeljoni është instrumenti i cili më ndihmon të komunikoj në mënyrë time, përmes asaj që di të bëj më mirë, me botën” thekson Armela me sytë që i shkëlqejnë.

Pavarësisht sfidave me të cilat u përballën gjatë rrugëtimit, Armela dhe ekipi i saj punuan pa u lodhur për arritjen e synimeve të tyre. Përmirësimi i përputhshmërisë me protokollin e Praktikave të Mira të Prodhimit (GMP) dhe standardet



japoneze 5S për përmirësimin e produktivitetit dhe higjienës

të rrisnin standardin e cilësisë, duke rritur kështu edhe besimin ndër klientët e tyre.

Ky transformim rrënjësor reflektohet më së miri në sukseset që Agromeljoni arriti gjatë programit, si dyfishimi i nivelit mujor të shitjeve, shtimin e bazës së klientëve me katër klientë të rinj biznesi në zonat turistike të Beratit, Tiranës dhe Vlorës, dhe një rritje mbresëlënëse prej 85% në zbatimin e protokollit të cilësisë GMP. Logo dhe marka e Agromeljonit gjithashtu u përmirësuan në mënyrë rrënjësore, si edhe u krijuan e prodhuan etiketa të reja më tërheqëse për produktet. Prania e biznesit në rrjetet sociale u përmirësua gjithashtu në mënyrë të dukshme.

Alketa Skëndaj, një konsulente biznesi me shumë përvojë, e cila e ndoqi Armelën në rrugëtimin 6-mujor të programit thekson: “Ky program,

i cili fokusohet në rritjen e konkurrueshmërisë dhe zgjerimin e tregut për bizneset e vogla, ka qenë jetik për zhvillimin e Agromeljonit. Kapacitetet e fituara përmes programit do të jenë thelbësore për vazhdimin e procesit të rritjes së këtij biznesi edhe në të ardhmen”.

Teksa i them mirupafshim Armelës, ajo me thotë me vendosmëri dhe vështrimin e ngulur në horizont: “Rrugëtimi ynë sapo ka nisur. Çdo sfidë vjen me një mundësi për t'u rritur. Ne do të vazhdojmë ta rrisim më tej Agromeljonin, kavanoz pas kavanozi”.

NGA FERMA NË TREGJET E HUAJA

Udhëzues për fermerët mbi përputhshmërinë me standardet GLOBALGAP



NGA FERMA NË TREGJET E HUAJA: Udhëzues për fermerët mbi përputhshmërinë me standardet GLOBALGAP

Qëllimi i udhëzuesit GlobalG.A.P është të ndihmore bizneset në procesin e tyre të certifikimit GlobalGAP, të sigurojnë përputhshmëri me praktikën ndërkombëtare bujqësore dhe të rrisin konkurrencën e tyre në treg.

GlobalGAP është një standard i njohur ndërkombëtar për praktikën e menaxhimit të fermave. Misioni i tij është të vendosë standarde dhe procedurë të pranuar gjerësisht për certifikimin e produkteve bujqësore në nivel global.



AVANTAZHE E CERTIFIKIMI GLOBALGAP



Për fermerët

- » Tregje të reja
- » Rritje e konkurrenshëmrisë
- » Çmime më të larta



Për konsumatorët

- » Sigurinë ushqimore: Masat për të parandaluar kontaminimin e ushqimeve
- » Zgjedhje të shumta dhe transparence
- » Përmirësimi i mirëqenies së komunitetit



Për ambientin

- » Inkurajon praktika të qëndrueshme bujqësore, duke përfshirë përdorimin e efektshëm të ujit dhe plehrave, dhe zvogëlon ndikimin negativ në ambient
- » Promovon praktika që ruajnë shëndetin e tokës dhe biodiversitetin, duke mbrojtur mjedisin dhe habitatin natyror
- » Praktika që reduktojnë ndikimin mjedisor të bujqësisë, siç janë menaxhimi i qëndrueshëm i ujit dhe përdorimi i kontroluar i pesticideve dhe plehrave kimike



HAPAT DREJT CERTIFIKIMIT



1. **Përgatitja dhe aplikimi:** Plotësoni dhe dorëzoni formularin e aplikimit tek organi i certifikimit (kohezgjatja 1-2 muaj).
2. **Rishikimi i dokumentacionit** nga trupa e certifikimit (p.sh., regjistrat e fermës, praktikën e menaxhimit) (1 muaj).
3. **Inspektimi** përfshin intervistime, inspektim të objekteve dhe rishikim të praktikave (1-2 muaj).
4. **Raporti i auditit** dhe veprimet korektuese nga organiza e certifikimit (1-2 muaj).
5. Implementoni **veprimet korektuese** nëse identifikohen mangësi (1 muaj).
6. **Vendimi për Certifikim** (1 muaj).
7. Pas miratimit, **organi i certifikimit jep certifikatën GlobalG.A.P.**

KËRKESAT PËR CERTIFIKIM

- » Udhëzime për organizimin e fermës, infrastrukturën, dhe higjienën (p.sh. udhëzimet për organizimin e rrugëve brenda fermës për të lehtësuar aksesin dhe kontrollin e trafikut të mjeteve bujqësore).
- » Menaxhimi i tokës (p.sh. praktika për testimin e rregullt të pH-së së tokës dhe përdorimi i rregullt i plehrave organike për të mbajtur fertilitetin e tokës).
- » Mbrojtja e kulturave bujqësore: IPM, përdorimi i pesticideve dhe mbajtja e regjistrimeve (p.sh. përdorimi i feromoneve).
- » Përdorimi efikas i ujit, standardet e cilësisë dhe praktikën e zjarrëdhënies.
- » Përdorimi i plehrave: aplikimi i duhur, ruajtja, dhe mbajtja e regjistrimeve për plehrat (ruajtja e plehrave në depo të mbyllura dhe mbajtja e regjistrimeve të sasisë dhe llojit të plehrave të përdorura).
- » Kullimi dhe trajtimi pas kullimit: procedurat për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e produktit nga kullimi deri te ruajtja.
- » Shëndeti, siguria dhe mirëqenia e punëtorëve: udhëzime për sigurinë e punëtorëve, trajnimet, dhe kushtet e punës (p.sh. organizimi i trajnimeve vjetore për procedurat e sigurisë në përdorimin e mjeteve bujqësore).

Dokumentimi dhe mbajtja e te dhenave

Dokumentacioni i nevojshëm përfshin hartën e fermës, regjistrat e kulturave, regjistrat e përdorimit të pesticideve dhe regjistrat e trajnimeve të punonjësve.

Praktikat e mbajtjes së regjistrimeve: përdorimi i sistemeve të automatizuara për regjistrimin e të dhënave, dhe rregullimi i dosjeve të regjistrimit në mënyrë që të përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar.

Roli i trupës së certifikimit

- » Konsultim fillestar për të shpjeguar procesin dhe kërkesat e certifikimit
- » Shërbime vlerësimi paraprak dhe planifikimi për auditim
- » Komentet dhe rekomandimet për veprime korigjuese
- » Lëshon certifikatën GlobalGAP nëse ferma rezulton të jetë në përputhje
- » Auditimet të rregullta mbikëqyrëse për të siguruar përputhshmërinë e vazhdueshme me standardet GlobalGAP
- » Monitoron veprimet korigjuese dhe përmirësimet e bëra bazuar në gjetjet e auditimeve të mëparshme
- » Menaxhon procesin e rinovimit për të ruajtur vlefshmërinë e certifikimit.
- » Ofron mbështetje dhe udhëzime të vazhdueshme për të ndihmuar fermën të ruajë përputhshmërinë
- » Ofron përditësime mbi ndryshimet në standardet dhe kërkesat e GlobalGAP



NJË INICIATIVË GLOBALE

GOJP ndihmon prodhuesit e vegjël për të përmirësuar cilësinë e produkteve të tyre, të përmbushin standardet ndërkombëtare dhe të eksportojnë nëpër botë

KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

Akademia e Shkencave Tiranë, prezanton librin me titull “Bujqësia Biologjike” me autor Profesor Asistent dhe Doktor Enver Isufi

Nga: Agim Rrapaj, Presidenti i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH)

23 Dhjetor, 2024

Shënim: Për lexuesit e gazetës sonë “AGROBIZNESI”, po ofroj komentin tim, të diskutantëve dhe të vetë profesor Enverit rreth librit të tij me titull “Bujqësia Biologjike”



Agim Rrapaj, Presidenti i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH)

Pata fatin të jem i ftuar nga Akademia e Shkencave të marr pjesë në prezantimin e librit me titull “BUJQËSIA BIOLOGJIKE” me autor Prof. Ass. Dr. Enver Isufi.

Në praninë e shumë personalitetve të bujqësisë shqiptare u prezantuan vlerat e këtij libri dhe vlerat e vetë autorit në shërbim të bujqësisë shqiptare për 50 vitet e fundit.



Prof. Ass. Dr. Enver Isufi
Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe
Bujqësinë Biologjike

Prof. Enver Isufi është bashkëpunor i rregullt i gazetës sonë të KASH me titullin e mirënjohur “AGROBIZNESI”. Ai prej tre viteve, dy herë në muaj në çdo numër gazete shkruan për problemet e bujqësisë, shërbimit këshillimor, bujqësisë biologjike, për sigurinë ushqimore, për mbrojtjen e bimëve. Këtë botim që sapo u prezantua, organizata jonë KASH e ka dhe do marrë edhe të tjera kopje për t’ua shpërndarë grupeve tona të fermerëve dhe ekspertëve të interesuar, me qëllimin e nxitjes së bujqësisë biologjike mes bizneseve tona bujqësore. Kjo

lloj bujqësie me standarde është një garanci për tregjet e fermerëve tanë, qoftë për tregun vendas, tregun e eksportit dhe për numrin e madh të turistëve që ushqehen me produktet e bujqësisë sonë.

Në prezantim morën pjesë agronomë me përvojë të gjatë profesionale, specialistë të përfshirë në bujqësinë biologjike, prodhues dhe eksportues të prodhimeve biologjike dhe akademikë.

Komentet shkencore u prezantuan nga dy profesorë: Profesor FATBARDH SALLAKU (Rektor në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Profesor ENDRIT KULLAJ, pedagog pranë Univieritetit Bujqësor të Tiranës.

Veprimtaria u drejtua nga Profesoreshë VJOLLCA IBRO, pedagoge pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Takimin e përshëndeti një përfaqësues i Akademisë së Shkencave,

Rreth librit të Prof. Ass. ENVER ISUFI dhe ndihmesës së tij profesionale në bujqësinë shqiptare në përgjithësi dhe në atë në bujqësinë biologjike në veçanti diskutuan kolegët:

- Profesor Ass. Dr. IRFAN TARELLI, në emër të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural përshëndeti botimin e librit dhe autorin si dhe prezantoi objektivat e kësaj Ministrie për zhvillimin e Bujqësisë Biologjike Shqiptare. Ai informoi se sapo u miratua në Parlamentin Shqiptar ligji i ri për Bujqësinë Biologjike, dhe është ngritur Grupi i Punës për strategjinë e zhvillimit të Bujqësisë Biologjike për 3-4 vitet që vijnë, si dhe mbështetjen financiare të kësaj bujqësie.

- Profesor ABDULLA KAPIDANI, ish Z/rektor i Universitetit Bujqësor dhe pedagog në Katedrën / sot Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve pranë Universitetit të Bujqësisë, theksoi se ky libër me vlera shkencore dhe zbatuese ka ardhur në kohën e duhur, kur Shqipërisë i duhet të bëjë një revolucion në produktet e certifikuar.

Kjo bujqësi është një sistem që mbështet sigurinë ushqimore dhe sigurinë e mbrojtjes së mjedisit nga ndikimet negative të teknologjive bujqësore.

- Profesor SOKRAT JANI, bëri vlerësimet e veta për librin dhe autorin, si dhe dha mendime dhe ide se si mund të ecet më shpejt në këtë sektor.

- Profesi Ass. Dr. REXHEP UKA, në fjalën e tij dha vlerësimet më të larta për këtë libër, si dhe shprehu disa mendime dhe ide dhe se duhet një këndvështrim më i gjerë e më kompleks për zhvillimin e bujqësisë biologjike, duke mbështetur të gjithë zinxhirin e vlerës në këtë sektor.

- Zoti AGIM RRAPAJ, presidenti i Agrobiznesit Shqiptar, (KASH), theksoi se ky botim ka qenë i mirëpritur nga rrjeti i shoqatave të biznesit, sepse është bujqësi që plotëson standardet e sigurta për tregun vendas dhe për eksportin.

- Zonja EVELINA AZIZAJ, sekretare e Rrjetit Rural Shqiptar (ANRD), theksoi rëndësinë e këtij libri për zhvillimin e bujqësisë biologjike dhe kontributin e autorit. Ajo përmendi se Instituti i Bujqësisë Biologjike që ai drejton është anëtar i Rrjetit tonë duke emancipuar anëtarin tonë me konceptet e bujqësisë së qëndrueshme dhe sigurinë ushqimore, sidomos kur sot bumi turistik, kërkon ushqim të standardizuar. Aftësia e tij për t’i shpjeguar fenomenet e vështira me argumente të thjeshta për cilindo, është ajo që më ka befasuar mua këto 7 vite që ai kontribuon në Rrjetin tonë të Zhvillimit Rural Shqiptar (ANRD).

- Programi u mbyll me një prezantim të autorit ENVER ISUFI, i cili nuk u fokusua tek libri i tij, por tek nevoja e mbështetjes së të gjitha proceseve që ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë biologjike si:

- Edukimi i fëmijëve për prodhimin biologjik dhe mbrojtjen e mjedisit
- Arsimimi me këto koncepte të nxënësve, studentëve, konsumatorëve
- Në shtimin e kërkimeve shkencore shoqëruar
- Me botime të të gjitha formateve

Me më shumë prani në median elektronike, pra një punë e integruar për këtë sistem modern bujqësie.

- Vetëm investimet dhe subvencionet nuk mjaftojnë, pa u kuptuar më parë dobia që ka nga ky sistem bujqësie për Prodhuesit, Konsumatorët dhe Mjedisin e gjerë ku punojmë e jetojmë.

Takimi me shokë e miq ishte një anë tjetër qetësuese në këtë fund viti.

Unë si autor i librit i falenderoj të gjithë pjesëmarrësit në këtë takim, të gjithë ato që i ka shkaktuar ndjenjë pozitive botimi dhe prezantimi i këtij libri dhe pa dyshim AKADEMINË E SHKENCAVE DHE UNIVERSITETIN BUJQËSOR, të cilët këtë ditë ua kushtuan vlerave të Bujqësisë Biologjike për sot dhe për nesër, për ekonominë, por edhe për mjedisin ku jetojmë e do jetojmë gjithmonë.

...FALENDEROJ FAMILJEN TIME, e cila më ka dhënë kaq shumë hapësirë kohe dhe të financave familjare, për botimet e mia:

• Agronomike, • Letrare, • Publicistike.

Nga autori librit, ENVER ISUFI.

BOTIM I RI

Akademia e Shkencave Tiranë, prezanton librin me titull “Bujqësia Biologjike” me autor Profesor Asistent dhe Doktor Enver Isufi

(Vijon nga faqja 10)

Foto të diskutantëve mbi librin “Bujqësia Biologjike”, me autor Enver Isufi (Vjollca Ibro, Përfaqësuesi i Akademisë, Fatbardh Sallaku, Endrit Kullaj, Abdulla Kapidani, Rexhep Uka, Evelina Azizaj, Sokrat Jani)



Miratohet Paketa e Maleve, Gonxhja: Nxit kthimin e shumë shqiptarëve nga jashtë vendit

(Vijon nga faqja 7)

përparësi zhvillimin malor dhe kanë nevojë për mbështetje të posaçme me qëllim rimëkëmbjen ekonomike, nxitjen e punësimit, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe shfrytëzimin me eficiencë të burimeve të natyrës, mbrojtjes së ekosistemit dhe vlerave territoriale dhe traditave, me theks zgjerimin e hartës turistike dhe shfrytëzimin e potencialit gjithëstënor të këtyre zonave në funksion të turizmit, si një motor kryesor zhvillimi ekonomik.

Projektligji synon të japë zgjidhje ligjore, specifike që paraqet situata aktuale me pasuritë e paluajtshme shtetërore, në zonat malore, si dhe ka për qëllim thjeshtimin e procedurave të për dokumentat e pronësisë dhe lejet e ndërtimit, dhe mbështetjen me lehtësi fiskale, për rigjallërimin e zonave rurale

e malore duke ndërtuar bujtina, agroturizma, ferma malore, etj.

Iniciativa për këtë projektligj merret në kuadër të “Programit të integruar për zhvillimin rural – Programi i 100 Fshatrave”, dhe më konkretisht, në kuadër të nismës “Investo në Tokën Tënde – Paketa e Maleve”, e cila synon të ofrojë një qasje alternative për tërheqjen e investimeve direkte dhe orientimin e tyre, për zhvillimin e atyre zonave rajonale/lokale të qeverisjes vendore, të identifikuar si zona me përparësi zhvillimin, që kanë nevojë për përdorimin e mekanizmave të veçantë, për zhvillimin ekonomik.

Për propozimin e këtij projektligji, janë marrë në konsideratë strategjitë e miratuara nga Komisioni Evropian, siç është Strategjia e Bashkimit Evropian për Rajonin e Alpeve (EUS-ALP). Kjo strategji adreson

sfidat dhe mundësitë kryesore për zhvillim e Alpeve, të cilat fokusohen në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe inovacionit, me vëmendje ndaj ndikimeve mjedisore.

Gjithashtu nisma ligjore “Paketa e Maleve” është në linjë me Axiendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, kapitulli 13 “Menaxhimin e Ekosistemeve të Brishta dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm Malor”, të cilat promovojnë politikat kombëtare, të ofrojnë stimuj për vendat në këto zona specifike, për diversifikimin e ekonomisë në zonat malore, duke nxitur turizmin, zhvillimin e aktiviteteve alpine, bujqësinë, përdorimin e teknologjive inovative dhe ruajtjen e mjedisit, si dhe menaxhimin e integruar të zonave malore dhe praktika të përshtatshme për ruajtjen e ekosistemit malor.

Fluturime direkte Izrael-Shqipëri, Rama: Mundësi për shkëmbime kulturore, turizëm dhe biznes

Kryeministri Edi Rama ndau lajmin e vendosjes së fluturimeve direkte nga Izraeli drejt Shqipërisë.

“Ky është një lajm i mrekullueshëm për forcimin e mëtijshëm të marrëdhënieve mes Izraelit dhe Shqipërisë!”, theksoi kreu i qeverisë në një postim në platformën X.

“Fluturimet direkte jo vetëm që e bëjnë udhëtimin më të përshtatshëm, por gjithashtu hapin dyert për shkëmbime kulturore, turizëm dhe mundësi biznesi. Lidhja historike midis dy vendeve, përfshirë rolin heroik të Shqipërisë në strehimin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore, është një themel për një lidhje më të thellë”, u shpreh Rama.

“Nxitja e izraelitëve për të eksploruar peizazhet befasuese, traditat e gjalla dhe ekonominë në rritje të Shqipërisë do të nxisë

pa dyshim miqësi dhe partneritete më të forta. Një e ardhme e përbashkët bashkëpunimi dhe respekti reciprok mund të çojë në mundësi të jashtëzakonshme për të dy vendet. Këtu ka shumë kujtime të paharrueshme dhe një miqësi të lulëzuar shqiptaro-izraelite”, theksoi Kryeministri.

Rama shprehu mirënjohje ndaj presidentit të Izraelit, Isaac Herzog.

“Mirënjohës ndaj një njeriu të jashtëzakonshëm, një udhëheqësi frymëzues dhe mikut tim të dashur, Isaac Herzog, i cili solli me vete në Shqipëri një grup sipërmarrësish të shquar izraelitë dhe për fjalët e tij inkurajuese drejtuar komunitetit hebre të biznesit duke i nxitur ata ta shohin Shqipërinë si një vend vëllazëror të mundësive”, u shpreh Rama.



REPORTAZH

BBC: Aventura e papërsëritshme në lumin e egër të Shqipërisë

Një nga lumenjtë e fundit të egër të Evropës, Vjosa përshkon rreth 272 kilometra nga malet e Pindit, në Greqi, në brigjet e Adriatikut në Shqipëri duke rrjedhur nëpër gryka të ngushta dhe lugina të gjera, ku ujërat e saj blu në jeshile rrëshqasin pranë rrënojave ilire, fshatrave të rrënuara nga koha dhe peizazheve të zymta malore, shkruan Dominis Horner për BBC.

Shtëpia e më shumë se 100 llojeve, përfshirë ngjalën evropiane të rrezikuar në mënyrë të konsiderueshme, lundërat dhe shkabën egjiptiane që shihet rrallë, Vjosa është më shumë se thjesht një lumë; ajo është një litër shpëtimi për komunitetet buzë lumenjve dhe një simbol i trashëgimisë dhe ripërtëritjes shqiptare.

Ujërat e saj bruz dhe habitatat e larmishme mbështesin jetën e egër, peshkimin, bujqësinë dhe gjithnjë e më shumë, eko-turizmin.

Në një lëvizje historike, në mars 2023, Vjosa u krijua si Parku i parë Kombëtar i Lumit të Egër në Evropë – një status që synon të ruajë ekosistemin dhe biodiversitetin e saj unik.

“Lumenjtë janë ndër habitatat më të rrezikuar të Evropës, me më pak se 10% rrjedhje të lirë”, thotë Beth Thoren, drejtore e veprimit mjedisor në Patagonia, e cila bashkëpunoi me qeverinë shqiptare për ngritjen e parkut kombëtar.

Thoren thekson rëndësinë e mbrojtjes së lumenjve si Vjosa.

“Duke qëndruar në brigjet e Vjosës, kupton se nuk ke parë kurrë një lumë vërtet të egër, pa diga, rezervuarë apo brigje betoni që kufizojnë rrjedhën e saj”, shton ajo.

Megjithëse Vjosa tani gëzon statusin e mbrojtur, kërcënimet e mundshme vazhdojnë.

Planet për digën e Kalivaçit, një projekt hidroelektrik në lumë, u anuluan në 2021 pas protestave publike, por presione të tjera priten.

Ndërtimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës pranë Lagunës Vjosa-Nartë – një ndalesë jetike për zogjtë migrues – ka alarmuar ambientalistët, ashtu si edhe një ligji i fundit që lejon zhvillimet e turizmit luksoz brenda zonave të mbrojtura.

Investitorë të mëdhenj si Jared Kushner po shikojnë tani Deltën e Vjosës për resorte të nivelit të lartë duke shkaktuar frikë se rajoni mund të përballet me ndryshime të pakthyeshme.

Mbërrita në fshatin Çarshovë dhe ndalova për drekë në një restorant buzë lumit, në pronësi të Ana Jankut, një banore e përjetshme në Vjosë. Restoranti i Jankut, si shumë të tjerë përgjatë lu-

mit, është tërësisht i vetëmjaftueshëm, me gjithçka që buron nga toka e familjes së saj: perime, bagëti dhe bukë e pjekur në shtëpi, si dhe peshk të sapo kapur (ndërsa po bisedonim, djali i saj Stavro ishte i zënë duke hedhur rrjetat e tij).

ar në mënyrë të sigurt pjesët më të pabesa të lumit.

Fola me Irma Takon, pronaren e pasionuar të kompanisë që themeloi “Explorer”, tetë vjet më parë, për të krijuar vende pune për të rinjtë në luginën e lumit Vjosa.

“Emigrimi është një nga

drejtë i një bashkëpunimi midis qeverisë shqiptare, aktivistëve vendas dhe partnerëve ndërkombëtarë si “Patagonia”, “EcoAlbania” dhe fushata “Save the Blue Heart of Europe”.

Këto përpjekje kanë dhënë rezultate mbresëlë-

Olsi Nika, drejtor ekzekutiv i “EcoAlbania” – një organizatë mjedisore në qendër të fushatës për statusin e Parkut Kombëtar të Vjosës – foli për ekuilibrin delikat midis zhvillimit turistik dhe ruajtjes: “Vjosa nuk është gati për një bum

nga bregu i lumit dhe një peshkatar i vetmuar me kaonën e tij kaloi përpara meje në rrjedhën e sipërme. Teksa i afrova grykëderdhjes dhe u ktheva përtej gadishullit, dallgët goditën anën e varkës sime të vogël me një forcë të tillë sa që gati u përmbys.

Më në fund, me pajisje të zhytura në ujë të kripur, dola në det të hapur. Skena përpara meje ishte aspak befasuese: në të majtën time, bregdeti i shkretë, malet e largëta, majat e tyre të mbuluara me re; në të djathtë time, horizonti i pafund i Adriatikut. Për ato kilometrat e fundit, ndjeva një qetësi të thellë medituese – një dorëzim i plotë ndaj fuqisë së botës natyrore.

I lashë valët të më çonin në breg, gjeta një shteg kthimi drejt qytetërimit, duke kaluar disa bunkerë të epokës komuniste të mbushur me grafitë dhe zbrita në qytetin e Vlorës.

Me përfundimin e aventurës sime, arrita në dy konkluzione aq të qarta për mua sa edhe ujërat e lumit.

Së pari, përcaktimi i Vjosës si Parku i parë Kombëtar i Lumit të Egër në Evropë përfaqëson jo vetëm një fitore ekologjike për Shqipërinë, por edhe një shembull bindës për përpjekjet mjedisore që mund të shtrihen shumë përtej kufijve të Ballkanit.

Statusi i saj ka potencialin të krijojë një precedent frymëzues: ruajtjen e lumenjve natyrorë të pandërrerë dhe ekosistemeve të ndërlidhura që ata mbështesin, ndërkohë që mbrohet nga kërcënimet si zhvillimi i tepërt, ndotja dhe humbja e habitatit.

“Ky park kombëtar krijon një model sesi duhet ruajtur natyra”, shpjegoi Nika.

“Është një sistem lumor i gjallë që rrjedh lirshëm nga burimi në det pa ndërhyrje njerëzore – jashtëzakonisht i rrallë sot. Që ky model duhet të vijë nga një vend i vogël me probleme të tij të mëdha duhet t’i japë shpresë pjesës tjetër të Evropës”, thekson ajo.

E dyta?

Fakti që Vjosa është një nga thesaret natyrore të Evropës, falë jo pak përpjekjeve të palodhura të grupeve të ruajtjes që punojnë në prapaskenë dhe atyre që jetojnë dhe punojnë përgjatë brigjeve të saj, duke siguruar që ajo të mbetet e paprishur.

Siç kishte thënë Ana atë ditën e parë në Çarshovë: “Shpresoj që lumi të mbetet ashtu siç ka qenë gjithmonë dhe si është tani – natyral dhe i egër”.



Teksa haja byrek, gulash dhe xaxiki të freskët, Janku më shpjegoi se si Vjosa e ka mbajtur familjen e saj për breza të tërë dhe ndërsa ajo e mirëpriti statusin e parkut kombëtar, ajo ende shqetësohet për zhvillimin e ardhshëm që mund të kërcënojë Vjosën.

“Ky lumë është gjithçka për ne. Ne u kujdesëm për të shumë kohë përpara se të mbrohej zyrtarisht”, thotë ajo.

Ajo shprehu lehtësim edhe për digën e Kalivaçit, tashmë e braktisur.

“Nëse dikush dëshiron të investojë në Vjosa, duhet të sigurohet që ta respektojë atë”, thotë ajo.

Duke vazhduar në drejtim të lumit, kalova nëpër fshatrat Kanikol, Strëmbec dhe Kaludh ku lumi mori një karakter më komunitar. Vendasit lahashin në “pishina” më të qeta, të rinjtë hidheshin nga shkëmbinjtë dhe peshkatarët qëndronin të qetë pranë bregut. Teksa përshkoja një grykë afër Kanikolit, një shqiponjë fluturoi dhe u lëshua poshtë drejt lumit.

Nga Kaludhi në qytetin e Përmetit, iu bashkova një grupi me kompaninë rafting “Vjosa Explorer” për të trajtu-

problemet më të mëdha të vendit tonë. Lugina është e bukur, por na mungojnë burimet njerëzore”, thotë ajo.

Tako theksoi gjithashtu nevojën për zhvillim të qëndrueshëm.

“Lumi është i yni dhe ai u përket të gjithëve, por nevojiten ende kufizime për të ruajtur biodiversitetin e tij dhe botën ujore që ai ka. Ndërsa statusi i parkut kombëtar është një hap i rëndësishëm, zbatimi dhe vigjilanca janë vendimtare për të ardhmen e lumit”, thotë ajo.

Ditën tjetër e kalova duke u larë në burimet e nxehta në Bënjë (të famshëm jo vetëm për ujërat e tyre të ngrohta qetësuese, por edhe për Urën simbolike shekullore të Kadiut të epokës osmane) përpara se të ecja me vozitje 20 kilometra deri në qytetin e Këlcyrës.

Prej këtu, lumi zgjerohet pak, por peizazhi mbetet dramatik me male të larta në çdo drejtim (afërsisht 70% e Shqipërisë është malore). Ndaloja për të notuar dhe vura re një lundër që rrahte brenda dhe jashtë shkëmbinjve.

Bollëku i dukshëm i jetës në lumë nuk është rastësi – është rezultat i drejtpër-

nëse: ruajtja e ujërave të lumit me rrjedhje të lirë dhe habitatet e lulëzuara, rritja e ndërgjegjesimit për vlerën e tij ekologjike dhe promovimi i praktikave të qëndrueshme, të gjitha duke mbështetur mirëqenien kulturore dhe ekonomike të komuniteteve buzë lumit.

“Parku Kombëtar i lumit të egër Vjosa mbron më shumë se thjesht natyrën”, tha Thoren.

“Ai u krijua në konsultim me komunitetet lokale për të siguruar ruajtjen e peizazhit natyror dhe trashëgimisë kulturore të rajoneve nëpër të cilat rrjedh”, shton ajo.

Të nesërmen, kalova me kajak nëpër grykën e Këlcyrës, një nga pasazhet më mahnitëse të Vjosës, ku lumi rrjedh midis faqeve të thepisura të maleve dhe ujëvarave poshtë shkëmbinjve. Nga këtu, udhëtimi mori një kthesë më sfiduese pasi infrastruktura aktuale dhe ajo turistike u pakësuan. Ajo që nuk u largua, megjithatë, ishte madhështia e ashpër e peizazhit, ndërsa lumi filloi të përhapej në një rrjet të gërshtuar kanalesh gjarpërore – duke zbuluar një pamje të botës tjetër.

Ajo ka potencial të madh, një përzierje e natyrës dhe kulturës me trekking, rafting dhe peshkim, por është e pazhvilluar, pothuajse një faqe bosh. Ne kemi nevojë për infrastrukturë dhe plane për turizmin duke siguruar që ne ta ruajmë Vjosën për brezin e ardhshëm”.

Thellësia kulturore e rajonit më goditi të nesërmen, ndërsa eksplorja rrënojat ilire të Bylisit, një qytet në majë kodre që luajti një rol kryesor në Ilirinë e lashtë në shekullin IV para Krishtit dhe u integrua më vonë në provincën romake të Epirus Nova, e cila përfshinte pjesë të Shqipërisë së sotme dhe Maqedonisë së Veriut.

Tani një vend kyç arkeologjik me pamje gjithëpërfshirëse të luginës, muret e tij fortifikuese të ruajtura, teatri dhe tempulli shërbejnë si kujtesë të së kaluarës së tij të historisë si një qendër tregtare dhe kulturore nga një epokë e shkuar.

Në ditën e fundit, moti ishte i kthjellët dhe era frynte, ndërsa unë po vozisja drejt grykës së Adriatikut.

Rrjeta të gjera vareshin

KËNDI I EKSPERTIT

Bimësia spontane e mureve

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Ne jemi mësuar t'i shohim bimët e ndryshme të rriten dhe zhvillohen në tokë, bile në tokë të punuar mirë. Por bimët kanë aftësi të mbijnë, të rriten dhe të zhvillohen dhe në mjediset që nuk janë të zakonshme

diversitetin dhe shëndetin e përgjithshëm të hapësirave të



Një kuti postare e kuqe fshati e vendosur në një mur guri. Drejtika varet në pjesën e sipërme të murit dhe në fund po rriten lulëkuqet dhe hithra.

për to, si në mure dhe trotuare. Kjo tregon për plasticitetin e tyre dhe aftësinë e tyre për t'u përshtatur me mjediset nga më të ndryshmet. Duke shëtitur rrugëve të një fshati bile dhe të një qyteti, shpesh të ze syri shumë bimë që dalin nga muret e shtëpive, sidomos atyre të ndërtuara me tulla dhe akoma më tepër të atyre të ndërtuara me qerpiç (plitharë). Po kështu dhe në trotuare ka një shumëllojshmëri të bimëve të ndryshme nga ato të egrat dhe deri tek ato të kultivuara, nga bimët barishtore deri tek shkurret dhe pemët frutore.

gjelbërimit në qytetet tona.

Origjina e bimëve të trotuareve dhe mureve shpesh pasqyrojnë diversitetin kulturor dhe kontekstin historik të qyteteve dhe qyteteve tona. Shumë prej tyre janë specie jo vendase që janë futur përmes aktivitetit njerëzor, tregtia ose transporti. Këto bimë shpesh tregojnë histori njerëzore migrimi, tregtia dhe lidhjet historike midis rajoneve të ndryshme. Ata demonstronjë ndër lidhje të kulturave globale dhe evolucionit të peizazhit urban me kalimin e kohës. Këto bimë të egra urbane janë gjithashtu vlera të natyrshme nxitjen e biodiversitetit. Pavarësisht duke u etiketuar si "barërat e këqija", ata luajnë një rol vendimtar në mbështetjen e insekteve të ndryshme, zogjve dhe kafshëve të vogla. Ata kontribuojnë për biodiversitetin e përgjithshëm urban, duke ofruar burimet dhe habitatet për një mori specimesh. Duke njohur rëndësinë e tyre në ekosistemin urban mund të çojë në më shumë strategji konservimi dhe peizazhi i informuar duke promovuar bashkëjetesën e specieve vendase dhe e prezanuar për një mjedis më të pasur dhe më elastik.

Studimi i bimëve që rriten në mure nuk kanë të bëjnë vetëm me njohjen dhe ekzistencën e tyre; por ka të bëjë me njohjen e vlerave të tyre për njerëzit dhe biodiversitetin. Ato mund të ofrojë njohuri mbi ekologjinë, historinë, kulturën dhe biodiversitetin, duke ofruar një lente zmadhuese përmes të cilave mund të kuptojmë më mire dhe përshtaten me urba-

nin tonë që ndryshon peizazhet me shpejtësi.

Bimët, më shumë se shumica e organizmave të tjerë, mund të ketë pamje të ndryshme brenda një specie individuale. Kjo është përgjithësisht në përgjigje ndaj kushteve të ndryshme të rritjes. Një bimë që rritet në një çarje muri me akses i kufizuar në lëndë ushqyese dhe lagështi mund të duket krejt ndryshe nga e njëjta specie që rritet në një kullotë të harlisur ose anë pacele toke. Kjo ndryshueshmëri brenda një specieje për shkak në mjedisin e tij njihet si "fenotip", "plasticitet" dhe mund të jetë shumë konfuz për një botanist fillestar.

Duke pasur parasysh se muret, trotuaret dhe struktura të tjera të bëra nga njeriu janë një mjedis ekstrem, për shumicën e bimëve, plasticiteti fenotipik i specieve është i një rëndësie të veçantë për botanistët urbanë. Në përgjithësi, bimët që rriten në mjediset ekstreme siç janë çarjet e trotuarit dhe mureve ka gjasa të jenë më të vogla se ato të rritura në më shumë kushte të moderuara.

Në muret e ndërtesave të ndryshme mund të rriten bimë me lule, myshqe, fiere etj. Nga bimët që rriten në mure përmendim :

Koridali i verdhë (Pseudofumaria lutea (L.) Borkh.)

Pseudofumaria lutea (sinonimi. Corydalis lutea), Koridali e verdhë ose tymi shkëmbor, është një bimë shumëvjeçare jetëshkurtër



në familjen e lulekuqes Papaveraceae. Është vendas në ultësiat jugore të Alpeve jugperëndimore dhe qëndrore të Italisë dhe Zvicrës, Gadishullin Ballkanik dhe e natyralizuar në të gjithë Europën dhe vënde

të tjera të botës. Një bimë e bukur me lule të verdhë të ndezur, lule në formë borie dhe gjethe të ndara thellë. Bima formontuma kompakte në mure. Bimë e Familjes së lulekuqes - Papaveraceae. Bimë shumëvjeçare me lartësi rreth 30 cm. Lulëzon gjatë muajve maj-tetor. Koridali i verdhë rritet në 30-38 cm i gjatë. Gjethet janë të ndara imët dhe të verdhë-jeshile në gri-jeshile, shpesh të mbetura gjatë dimrit.

Lulet janë 2 centimetra të gjata, në formë hinke me ngjyrë të verdhë, të bartura në kërcell, në kërcell të shkurtër, të degëzuar dhe me gjethe nga fundi i pranverës deri në vjeshtë. Ata kanë 4 petale; ato të sipërme dhe të poshtme me kreshtë, pjesa e sipërme me një shtyllë të shkurtër e të rumbullakosur të lakuar poshtë, 2 të brendshmet të lidhura në majë. Farat e saj, kafe të errëta me elaiozome të bardha, mbahen në bishtaja ovale, të sheshta. Bimët mbijnë me bollëk nga farat e tyre.

Latrapeci i madh (Chelidonium majus L.)

Latrapeci i madh është një bimë barishtore shumëvjeçare me lule të familjes së lulekuqes Papaveraceae. Një nga dy speciet në gjininë Chelidonium, është vendas në Evropë dhe Azinë Perëndimore dhe është futur gjerësisht në Amerikën e Veriut, një bimë e zakonshme që prodhon lule të verdha në pranverën e hershme, duke u riprodhuar ose me farë ose me bulba në bazën e kërcellit. Kjo bimë ka lule të vogla si lulekuqe



me katër petale të verdha. Ajo ka gjethet me lobe dhe frutat janë të ngushta kapsula (të rrethuara në të verdhë).



Familja e lulekuqes - Papaveraceae. Bimë shumëvjeçare me lartësi 90 cm. Lulëzon në maj-gusht.

Bima e njohur si Latrapeci i vogël (Ficaria verna) nuk është

e lidhur ngushtë me këtë, pasi i përket familjes së zhabinave Ranunculaceae.

Përshkrimi. Latrapeci i madh është një bimë barishtore shumëvjeçare me një kërcell të ngritur dhe arrin lartësinë 30-120 cm. Gjethet blu-jeshile janë të mbështjella me buzë me buzë dhe me onde, deri në 30 cm të gjata. Kur lëndohet, bima nxjerr një lateks të verdhë në portokalli.

Lulet përbëhen nga katër petale të verdha, secila rreth 18 mm e gjatë, me dy sepale. Një varietet me dy lule ndodhet natyrisht gjithashtu. Lulet shfaqen nga fundi i pranverës deri në verë, nga maji deri në shtator në vila me rreth katër lule.

Farat janë të vogla dhe të zeza, të vendosura në një kapsulë të gjatë cilindrike. Secila ka një elaiozomë, e cila tërheq milingonat për të shpërndarë farat (myrmecochory).

Marrulja e murit (Mycelis muralis)

Njihet dhe si Lactuca muralis, marule murale, është një bimë shumëvjeçare me lule në tribune Cichorieae brenda familjes Asteraceae. Karakteristika kryesore e saj janë tufat e hapura të ajrosura me lule të verdha. Çdo "lulëri" është në fakt një lule e përbërë, e përbërë nga 4-5 lule të ngjashme me petale (lule me rrip ose rreze), secila rreth 5-7 mm në gjatësi. Nuk ka lule disku. Lactuca muralis rritet rreth 0,6-1,2 m i gjatë me gjethet e poshtme të dhëmbëzuara dhe të kapura.



Lactuca muralis është barishte e hollë, pa qime që rritet nga 25 në 150 cm e gjatë. Shpesh ka kërcell të purpurt dhe nxjerr një lëng qumështi. Gjethet e poshtme janë në formë lyre. Lobet janë në formë trekëndore, lobi terminal është më i madhi. Gjethet e sipërme janë pa kërcell, më të vogla dhe me më pak lobe. Të gjitha gjethet janë me nuancë të kuqe.

Akenet janë me sqep të shkurtër, në formë gishti dhe të zinj. Pappusi ka qime të thjeshta të bardha, të brendshmet më të gjata se të jashtmet.

Kokat e luleve janë të verdha, të vogla me vetëm 4-5 lule me rreze të verdha. 1 cm e gjerë pak a shumë, në degë 90 gradë me kërcellin kryesor, në panik të lëshëm. Lulëzon nga qershori deri në shtator.

Lactuca muralis është e ngjashme me Lactuca serriola L. dhe

Lactuca virosa L. por dallohet qartë duke pasur vetëm 5 petale.

Një bimë e kultivuar e familjes së margaritës, me gjethe të ngrënshme që janë një përbërës i zakonshëm i sallatave. Shumë lloje marule janë zhvilluar me një sërë formash, tekstore dhe ngjyrash. Sallata e murit ka lule të vogla të verdha të hapurame pesë "petale" (këtu janë në të vërtetë pesë rreze lulet). Gjethet e poshtme janë në formë lire, kurse gjethet e sipërme janë më të vogla dhe me pak lobe, me bazamente në forme shigjete. Familja Daisy - Asteraceae. Bimë shumëvjeçare me lartësi 100 cm. Bima lulëzon në muajt korrik-shtator.

Lactuca muralis është një vendas i Evropës, por ka pushuar rrugët me hije, shtigjet dhe zonat e rrepta të Paqësorit Veriperëndimor dhe Anglisë së Re. Ajo është natyralizuar në pjesë të Irlandës së Veriut qysh në vitin 1913. Ajo u regjistrua për herë të parë në The Burren, ku tani është e shpeshtë, në vitin 1939.

Mund të gjendet në pyje, veçanërisht në pyje Ahu. Gjenet gjithashtu në tokat gëlqerore dhe në mure.

Raketa murale vjetore (Diplotaxis muralis)

Diplotaxis muralis, është një specie bimore e lulëzuar në familjen Brassicaceae. Kjo bimë është vendase në Evropë. Azi dhe Afrikë, por ajo gjendet në të gjithë botën e butë, ku është natyralizuar. Kjo është një bimë e ngritur si mustardë që rrallë arrin gjysmë metri në lartësi. Ajo ka gjethet me lobe dhe kërcjtee saj janë të mbuluar me tufë lulesh të dendura me lule të verdha, ose herë pas here të purpurta të lehta, me petale të vogla ovale dhe antera të mëdha. Fruti është një silikë i ngjashëm me kreshtën dy deri në katër centimetra. Një bimë evropiane me lule të verdha e cila i ngjan mustardës dhe lëshon një erë të rëndëkur shtypet. Kjo bimë ka lule të vogla të verdha mekatër petale ovale. Frutat janë ngushtuar në dy skajet, dhe ato janë të kënduara lartnga kërcelli (i rrethuar në të verdhë).

Përshkrimi. Është



njëvjeçare, por nganjëherë rritet si shumëvjeçare, duke u rritur deri në 15-60 cm në kërcell të padegëzuar. Ajo ka gjethet me lobe, të cilat formojnë një rozetë në bazën e bimës. Ato janë 2-9 cm të gjata dhe 1-3 cm të gjera. Ai lulëzon në verë, midis majit dhe shtatorit. Lulet janë të verdha, me sepale



Fragment i një muri të vjetër guri në qytetin e vjetër. Bimët rriten në këtë mur guri



PËRFITO

NORMAT MË TË MIRA
TË INTERESIT



Depozita e Artë

- Hap depozitën **36 Muaj**
- Normë interesi deri në **4.5%** në Lekë dhe **3.5%** në Euro

Skano për
më shumë

